



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Komuna e Obiliqit - Opština Obilič - Municipality Obiliq
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë

Datë/Data/Date	08.11.2024
Nga/Od/From:	Arben Berisha –Drejtore i DPUKP-së
Përmes/Preko/Through:	z.Xhafer Gashi – Kryetar i Komunës
Për/Za/To:	Znj.Vlora Mjekiçi Kabashi – Kryesuese e Kuvendit Komunal
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkesë për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme

E nderuar !

Fillimisht ju njoftojmë se bazuar në legjislacionin në fuqi Komuna e Obiliqit është në fazën finale të projekt Hartës Zonale të Komunës së Obiliqit 2024-2032 .

Me datë 03.10.2024 kemi bërë kërkesën me nr. protokolli 02-104-02-30030-24 në Ministrinë e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përkatësisht në Departamentin e Planifikimit Hapësinor për marrje të vendimit për pëlqim për miratimin e dokumentit “Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032”, me datë 08.11.2024 kemi pranuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përkatësisht Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm *Vendimin për dhënien e pëlqimit për miratim të Projekt “Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032”* .

Andaj bazuar në neni 11 dhe 16 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, dhe bazuar në atë që u cek më lartë kërkojmë nga ana e juaj që të thirrni mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal për miratimin e projekt – “ Harta Zonale e Komunës së Obiliqit të Obiliqit 2024-2032 ” përkatësisht t’a thirrni mbledhjen për dt. **15.11.2024 ditë e Premte** .

Me respekt .